



Sipas autoritetit të dhënë nga Neni 58.7 i Ligjit për Rregulatorin e Energjisë, Bordi i Zyrës së Rregulatorit për Energji në seancën e mbajtur më **27.05.2009** ka miratuar:

## RREGULLËN PËR KUSHTET E PËRGJITHSHME TË FURNIZIMIT ME ENERGJI

### KAPITULLI 1 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Fushëveprimi

- 1.1 Dispozitat e rregullës janë të aplikueshme për ndërmarrjet e energjisë që ofrojnë shërbime të energjisë dhe bëjnë furnizimin me energji (në tekstin në vazhdim “ndërmarrjet e energjisë”) dhe te konsumatorët fundorë që shfrytëzojnë këto shërbime dhe energjinë (në tekstin në vazhdim “konsumatorët”).
- 1.2 Rregulla përcakton termat dhe kushtet vijuese:
  - a) parimet dhe elementet e Marrëveshjes për Kyçje;
  - b) kyçjen në sistem;
  - c) shfrytëzimin e sistemit;
  - d) termat dhe kushtet e Kontratës për Furnizim;
  - e) qasjen në pronë të konsumatorit;
  - f) leximin e njehsorëve dhe faturimin;
  - g) pagesën e faturave dhe shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë;
  - h) detyrimet e furnizuesit për të kompensuar konsumatorët për energjinë e pa dërguar ose përfshirë furnizimin me cilësi të ulët energjie ose shërbimi, në përputhje me cilësinë e standardeve të shërbimeve, siç është e përcaktuar në kodet teknike dhe licencën përkatëse dhe në Rregullat e Tregut të aprovuar nga ZRRE-ja.
- 1.3 Gazi Natyror dhe të gjitha çështjet në lidhje me furnizimin dhe shërbimet e gazit natyror nuk janë të mbuluara nga kjo Rregull.

#### Neni 2 Struktura

- 2.1 Kjo Rregull përfshin dispozitat dhe Shtojcat që janë pjesë integrale e saj.
- 2.2 Format e aplikacioneve për kyçje dhe furnizim, oferta për kyçje dhe kontrata për furnizim të përfshirë në shtojcat e kësaj Rregulle, japos vetëm elementet bazë që duhet të përmbajnë dokumentet përkatëse; furnizuesi mund t'u shtojë këtyre formave çfarëdo informate tjetër të nevojshme, në rast se këto informata janë në pajtim me parimet e vendosura në këtë Rregull, dhe nuk bien ndesh me to në asnjë mënyrë.



- 2.3 Format e standardizuara të përgatitura nga furnizuesi në përputhje me Nenin 2.2., do të dorëzohen për aprovim tek Zyra e Rregulatorit për Energji ("ZRRE"), dhe pastaj të botohen në faqen elektronike zyrtare të furnizuesit.

**Neni 3**  
**Përkuftimet**

- 3.1 Në këtë Rregull, përvçese kur nuk kërkohet ndryshe nga konteksti:

- a) "**Marrëveshja për Hyrje**" nënkuption dokumentin e nënshkruar nga të gjitha palët të cilat janë pajtuar që t'i përbahen Rregullave të Tregut.
- b) "**Taksa e aplikimit**" nënkupton taksën që mbalon shpenzimet administrative të operatorit të sistemit për procedimin e një aplikacioni për kyçje, të publikuar nga furnizuesi pas aprovimit të ZRRE-së.
- c) "**Periudha e faturimit**" nënkupton periudhën e specifikuar në numrin e ditëve duke filluar nga dita e nxjerrjes së llogarisë së fundit, deri ne ditën kur fatura do të dërgohet në adresën e konsumatorit, ashtu siç është specifikuar në kontratën e furnizimit.
- d) "**Marrëveshje për kyçje**" nënkupton marrëveshjen ndërmjet operatorëve të sistemit dhe shfrytëzuesve të sistemit, që përshkruan procedurat e kyçjes, fillimit, mirëmbajtjes dhe përfundimit të kyçjes në sistem.
- e) "**Metodologjia e taksave për kyçje**" nënkupton metodologjinë e zhvilluar nga operatorët e sistemit, në përputhje me Nenin 5 të kësaj Rregulle.
- f) "**Taksat e kyçjes**" nënkupton taksat që do të paguhen nga shfrytëzuesit e sistemit për kyçjen në rrjet, siç është e përcaktuar nga dispozitat e Rregullës mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Metodologjinë e Tarifave, të nxjerrë nga Zyra e Rregulatorit për Energji dhe metodologjia e taksave për kyçje.
- g) "**Energjia**" nënkupton çdo formë të energjisë së prodhuar ose të përfituar (energji elektrike, ngrohje) e destinuar përfundimisht për furnizim ose shitje.
- h) "**Ndërmarrje e energjisë**" nënkupton një ndërmarrje të energjisë e cila kryen një ose më shumë nga aktivitetet energjetike në vijim: prodhimin, transformimin, transmisionin, shpërndarjen, furnizimin, tregtimin ose depozitimini e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose gazit natyror, në bazë të një licence të lëshuar sipas Ligjit për Rregulatorin e Energjisë, apo pa licencë nëse licenca në fjalë nuk kërkohet.
- i) "**Marrëveshja Kornizë e Rregullës së Tregut**" nënkupton marrëveshjen ndërmjet operatorëve të sistemit dhe shfrytëzuesve të sistemit, sipas të cilës Rregullat e Tregut bëhen detyruese midis palëve (më poshtë **Marrëveshja Kornizë**).



- j) **“Rrjeti”** nënkupton infrastrukturën e nevojshme për transmisionin ose shpërndarje të energjisë (energisë elektrike dhe ngrohjes).
  - k) **“Pala Aplikuese”** nënkupton palën e cila dëshiron të nënshkruajë një Marrëveshje për Hyrje.
  - l) **“Furnizues”** nënkupton ndërmarrjet e licencuara të energjisë që furnizonë konsumatorët përfshirë furnizuesin publik dhe furnizuesin/tregtarin.
  - m) **“Sistemi”** nënkupton një sistem me pajisje të ndërlidhura me qëllim të transmisionit (bartjes) dhe shpërndarjes të energjisë elektrike ose energjisë për ngrohje ose gazit natyror për klientët.
  - n) **“Operatori i sistemit”** nënkupton operatorin e sistemit të bartjes ose shpërndarjes së energjisë elektrike dhe operatorin e sistemit të shpërndarjes së ngrohjes, pronësisë në të dhe është përgjegjës për vënien në veprim të sistemit, sigurimin e mirëmbajtjes së rrjetit dhe zhvillimit të tij në një zonë të caktuar, dhe aty ku është e zbatueshme, vendos ndërlidhjet e veta me rrjetet e tjera dhe siguron aftësinë afatgjatë të rrjetit për të përbushur kërkeshën për energji.
  - o) **“Shfrytëzues të sistemit”** nënkupton personat fizikë dhe juridikë që fusin ose tërheqin energji elektrike në dhe nga sistemi i rrjetit të transmisionit dhe/ose shpërndarjes duke transportuar energjinë elektrike në sistemet e transmisionit dhe shpërndarjes, për qëllim të furnizimit, importimit ose eksportimit të energjisë elektrike.
  - p) **“Shfrytëzim i paautorizuar i energjisë”** nënkupton shfrytëzimin e energjisë ashtu siç është e **përcaktuar** në kapitullin e 8.
  - q) **“Shfrytëzimi i pa kontraktuar”** nënkupton shfrytëzimin e energjisë ashtu siç është përcaktuar në nenin 28.1.
  - r) **“Abuzimi i njehsorit dhe ndërhyrja në kyçje”** nënkupton shfrytëzimin e energjisë ashtu siç është përcaktuar në nenin 28.2.
  - s) **“Vjedhje e energjisë”** nënkupton shfrytëzimin e energjisë ashtu siç është përcaktuar në nenin 28.3.
  - t) **“Metodologja e Tarifave”** nënkupton vendimin që do të merret prej ZRRE-së për të mbuluar përcaktimin e të ardhurave vjetore të lejuara totale të cilat mund të fitohen prej tarifave të rregulluara, si dhe për të përcaktuar parimet që administrojnë strukturën e tarifave të përdorura për të mbuluar këto të ardhura vjetore.
- 3.2 Çdo term tjetër i përdorur në këtë Rregull, do të ketë të njëjtin kuptim si termat e përdorur në Ligjin për Energjinë, Ligjin për Rregulatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Ngrohje Qendrore, dhe çdo Ligj dhe Rregullore që janë të aplikueshme në Kosovë.



**Neni 4**  
**Parimet e Përgjithshme, të Drejtat dhe Detyrimet**

4.1 Në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulle, të gjithë konsumatorët kanë të drejtën dhe detyrimin që të:

- kenë trajtim të drejtë dhe jo diskriminues gjatë furnizimit me energji nga furnizuesit, si dhe të kenë qasje të hapur në informata nga furnizuesit;
- kërkojnë kryqe të objekteve dhe pajisjeve të tyre energjetike në rrjetin e operatorit të sistemit, nëse një kryqe e tillë është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur, sipas dispozitave të Kodit të Rrjetit ose Shpërndarjes, ose të ndonjë kodi teknik ose rregulloreje tjetër të aplikueshme;
- kenë marrëdhënie kontraktuese transparente me furnizuesin;
- paraqesin ankesa sipas dispozitave të Rregullës mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve kundër çdo akti të paligjshëm ose anashkalimi nga ana e furnizuesit;
- paguajë për energjinë e shfrytëzuar dhe për shfrytëzim të sistemit, sipas kontratës me Furnizuesin e Energjisë dhe tarifat e rregulluara dhe/ose tarifat e rrjetit të aprovuara nga ZRRE-ja;
- marrin kompensim nga furnizuesi, për energjinë e pa-dërguar ose për furnizim me shërbim dhe energji të cilësisë së dobët, në përputhje me marrëveshjet për furnizim dhe standardet e shërbimit që i ofrohet konsumatorëve, përfshirë cilësinë e shërbimeve, sigurinë dhe besueshmërinë e furnizimit të parashikuar në këtë marrëveshje.

4.2 Furnizuesi duhet të:

- nënshkratë marrëveshjen për kryqe dhe marrëveshjen kornizë me operatorët e sistemit në emër të vet dhe në emër të konsumatorëve;
- jetë në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulle dhe çdo Rregulle tjetër të aplikueshme, kodeve teknike dhe komerciale;
- fatuojë dhe mbledhë pagesat prej konsumatorëve;
- hartojë ofertat, kontratat, faturat, deklaratat dhe njoftimet që u adresohen konsumatorëve;
- themelojë një departament përgjegjës për mbrojtjen, sigurimin e informacioneve, përkrahjen dhe këshillimin për konsumatorët (përfshirë shërbimin e konsumatorëve, nivelin e ulët të tensionit, pajisjet për ngrohjen e ujit, hetime për faturat, ndërprerjet e furnizimit, etj.);
- mbajë dhe rifreskojë të dhënat në lidhje me matjen, faturimin dhe pagesën e faturave ose të dhënavë të nevojshme, ashtu siç përcaktohet në këtë Rregull dhe në kodet përkatës;
- merret me ankesat e konsumatorëve të vet sipas dispozitave të Rregullës mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- ofrojë konsumatorëve shërbime në përputhje me standardet e punës dhe sipas standardeve teknike të vendosura nga normat në fuqi dhe Rregullat e ZRRE-së;



- i) sigurojë konsumatorët, së paku njëherë në vit, me një përbledhje me shkrim mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, e në veçanti në kohën e nënshkrimit të Kontratës së Furnizimit dhe me rastin e aprovimit të ndryshimeve të shpallura lidhur me furnizimin me energji të paraqitura në Kontratën e Furnizimit. Përbledhja e të drejtave të konsumatorëve duhet të miratohet nga ZRRE-ja;
- j) që paraprakisht të paraqesë për rishikim dhe aprovim në ZRRE, formën e Kontratës për Furnizim që i është ofruar konsumatorëve;
- k) sigurojë informacione për konsumatorin në emër të operatorit të sistemit.

4.3 Operatori i sistemit duhet të:

- a) jetë në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulle dhe çfarëdo rregulle tjetër të aplikueshme, kodeve teknike dhe atyre komerciale;
- b) përgjigjet brenda tridhjetë (30) ditësh ndaj çdo aplikimi për kyçje që është dorëzuar nga shfrytëzuesit e sistemit ose konsumatori i privilegjuar;
- c) bëjë kyçjen e çdo shfrytëzuesi të sistemit në përgjithësi, dhe të çdo konsumatori të veçantë nëse kjo kyçje është teknikisht dhe ekonomikisht e mundshme sipas kushteve të vendosur në këtë Rregull, Kodeve Teknike të aplikueshëm, Rregullave të Tregut, dhe marrëveshjeve përkatëse për kyçje;
- d) mirëmbajë kyçjet dhe rrjetin në përputhje me dispozitat e kodeve teknike dhe marrëveshjeve përkatëse për kyçje;
- e) arkëtojë prej shfrytëzuesve të sistemit taksat për shfrytëzim të sistemit;
- f) sigurojë lexim të saktë dhe të rregullt të njehsorëve;
- g) mbajë dhe rifreskojë të dhënat në lidhje me kyçjen, marrëveshjet për kyçje, aplikacionet për kyçje, aplikacionet për ndryshime; faturimin ndaj shfrytëzuesve të sistemit, ndërprerjet aksidentale dhe të planifikuara në furnizim dhe përputhshmérinë me kriteret e cilësisë, dhe të gjitha të dhënat e tjera në përputhje me dispozitat e Rregullave tjera të aplikueshme;
- h) rishikojë ankesat me shkrim në lidhje me çështjet e njehsorëve;
- i) testojë dhe riparojë kyçjet dhe njehsorët;
- j) sigurojë furnizuesit me informacione në lidhje me kyçjen dhe shfrytëzim të sistemit;
- k) shmangë çdo diskriminim gjatë ofrimit të shërbimeve;
- l) zhvillojë dhe dorëzojë për shqyrtim dhe aprovim në ZRRE, Metodologjinë e Taksave për Kyçje, përfshirë format e nevojshme për kyçjen dhe shfrytëzimin e sistemit, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Rregull dhe rregulla të tjera të nxjerrë nga ZRRE-ja;
- m) botojë në faqen elektronike zyrtare dhe sipas kërkësës, të vërë në dispozicion formën me shkrim të deklaratës më të fundit mbi Metodologjinë e Taksave për Kyçje të aprovuar nga ZRRE-ja, si dhe të batojë një njoftim në lidhje me këtë në gazetat ditore.

4.4 Çdo Furnizues dhe operator i sistemit është i detyruar që në pajtim me këtë Rregull të zhvillojë politika në lidhje me kushtet për kyçjen në sistem dhe furnizimin me energji, brenda një periudhe kohore që nuk i tejkalon nëntëdhjetë (90) ditë kalendarike pas marrjes së licencës. Të gjitha këto politika duhet të sigurojnë procedurë transparente dhe jo diskriminuese dhe t'i paraqiten ZRRE-së për rishikim dhe aprovim paraprakisht para hyrjes në fuqi. Këto politika



duhet bërë publikisht duke qenë në dispozicion në faqen zyrtare elektronike, shtypin ditor, njoftime, raporte publike dhe çdo mënyrë tjetër që duket e përshtatshme.

## KAPITULLI 2 FURNIZIMI ME NGROHJE

### Neni 5 Parimet e Përgjithshme Të Furnizimit me Ngrohje

- 5.1 Të gjithë konsumatorët fundorë do të kenë të drejtën, që nëse është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur, të gëzojnë shërbimin universal të furnizimit me ngrohje prej rrjeteve të ndërmarrjeve të energjisë të cilat kryejnë shërbime publike në përputhje me këtë Rregull.
- 5.2 Për momentin, furnizimi me ngrohje përdoret për ngrohjen e hapësirave, por mbase do të mund të përdoret edhe për furnizim me ujë të ngrohtë sanitari.
- 5.3 Furnizimi i ngrohjes për qëllime të ngrohjes së hapësirave, do të kryhet gjatë sezonit të ngrohjes i cili zakonisht zgjat prej 15 Tetorit deri në 15 Prill; në varësi të kushteve klimatike, sezoni i ngrohjes mund të shkurtohet ose zgjatet (furnizim i jashtëzakonshëm me ngrohje).
- 5.4 Sezoni i ngrohjes mund të zgjatet maksimalisht prej 1 Tetorit deri në 30 Prill, duke aplikuar furnizimin e jashtëzakonshëm me ngrohje sipas kushteve në vijim:
  - a) furnizimi i jashtëzakonshëm me ngrohje do të aplikohet në rast se sipas të dhënave të shërbimeve meteorologjike ose sipas të dhënave prej ngrohtores temperatura e jashtme e matur në orën 21:00 në zonën e mbuluar prej ndërmarrjes së ngrohjes qendrore, për tre ditë rresht regjistrohet më ulët se  $12^0\text{C}$ ;
  - b) furnizimi i jashtëzakonshëm me ngrohje do të përfundojë kur sipas të dhënave të shërbimeve meteorologjike ose sipas të dhënave prej ngrohtores temperatura e jashtme e matur në orën 21:00 në zonën e mbuluar prej ndërmarrjes së ngrohjes qendrore, për tre ditë rresht regjistrohet më e lartë se  $12^0\text{C}$ .
- 5.5 Sezoni i ngrohjes do të shkurtohet duke ndaluar furnizimin me ngrohje vetëm në rastet kur sipas të dhënave të shërbimeve meteorologjike ose sipas të dhënave prej ngrohtores temperatura e jashtme e matur në orën 21:00 në zonën e mbuluar prej ndërmarrjes së ngrohjes qendrore, për dy ditë rresht regjistrohet  $12^0\text{C}$ , ose është më e lartë, dhe kur parashikimet e motit prej shërbimeve meteorologjike parashohin se temperatura për tre ditët në vijim do të jenë më të larta se  $12^0\text{C}$ .



### KAPITULLI 3 KYÇJA NË SISTEM

#### Neni 6

##### Parimet e Përgjithshme të Metodologjisë së Taksave për Kyçje

- 6.1 Operatorët e sistemit duhet të zhvillojnë metodologjinë e taksave dhe procedurat për kyçje në përputhje të plotë me rregullën për "Metodologjinë e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike" të aprovuar nga ZRRE-ja, e që përfshin taksat për:
- a) aktivitetet paraprake të nevojshme për të skicuar, ndërtuar dhe mirëmbajtur kyçjen si përgjigje ndaj një aplikimi nga shfrytëzuesi i sistemit dhe konsumatorët e privilegjuar;
  - b) instalim të linjave elektrike ose gypave për ngrohje, pajisjeve energjetike ose njehsorëve për qëllim të kyçjes në pikat hyrëse ose dalëse në rrjete;
  - c) aktivitete për qëllime të kyçjes ose modifikimit të sistemit;
  - d) rrethanat kur linjat elektrike, gypat për ngrohje, ose pajisjet energjetike për instalim janë të një madhësie më të madhe se sa është kërkuar për shfrytëzim të rrjetit;
  - e) mirëmbajtje dhe riparim ( përfshirë çdo shpenzim kapital) i kërkuar për kyçje dhe sigurim dhe instalim të njehsorëve për të bërë një kyçje në rrjet, nëse është e aplikueshme;
  - f) kufij ndërmjet rrjetit të bartjes dhe atij të shpërndarjes në relacion me aplikantët e rinj;
  - g) shkyçjen nga rrjeti dhe heqjen e pajisjeve (linjave, njehsorëve, gypave) si pasojë e shkyçjes;
  - h) deaktivizimi i një kyçjeje në rastet kur një stabiliment i energjisë është i konservuar por i gatshëm përfunkcionim
- 6.2 Metodologia e Taksave për Kyçje duhet të përmbajë dispozita lidhur me të drejtën e aplikantëve për të bërë ankesë në ZRRE, kundër ofertave për kyçje të ofruara nga operatorët e sistemit.
- 6.3 Metodologia e taksave për kyçje duhet të hartohet në atë mënyrë që të mos ketë diskriminim ndërmjet palëve të ngjashme që kyçen në rrjet kur bëhet venia e taksave për kyçjet e reja ose për zëvendësimin ose ndryshimin e kyçjes ekzistuese.

#### Neni 7 Aplikimi për Kyçje

Bazuar në Metodologjinë e Taksave dhe procedurave për Kyçje, aplikuesi dorëzon aplikacionin e vet tek furnizuesi i cili e procedon tek operatorët e sistemit, sipas Aneksit A të kësaj Rregulle.

#### Neni 8 Oferta për Kyçje

- 8.1 Pas regjistrimit të aplikacionit për kyçje/ ose modifikim të kyçjes, operatori i sistemit duhet bërë marrëveshjet e nevojshme që të studioj kërkzesat teknike të kyçjes, nëse është e



nevojshme të vizitojë pronat që janë subjekt i aplikimit dhe të hartojë dhe dërgoi ofertën për kyçje në formë të shkruar, sipas Shtojcës B të kësaj Rregulle.

8.2 Oferta për kyçje duhet të përbajë elemente në lidhje me:

- a) ata aplikant siç është përcaktuar në Metodologjinë e Tarifave dhe në Metodologjinë e Taksave për Kyçje, masat e nevojshme për të kyçur një shfrytëzues të sistemit në rrjetet ekzistuese të transmisionit ose shpërndarjes si dhe marrjen e pëlgimit të nevojshëm për këtë qëllim; të cilat si rezultat i kësaj janë emërtuar si “ kyçje e cekët”.
- b) ata aplikant siç është përcaktuar në Metodologjinë e Tarifave dhe në Metodologjinë e Taksave për Kyçje, punët e nevojshme për zgjerim ose përforcim të rrjetit të transmisionit dhe shpërndarjes, për të rregulluar kërkesën e supozuar ose kriteret për kapacitet të aplikantit; në këtë mënyrë i emërtuar si “ kyçje e thellë”.
- c) për ata aplikant që furnizohen nga një nivel i caktuar tensioni dhe që bien brenda një kërkesë maksimale dhe që gjenden në distancë të caktuar nga rrjeti ekzistues i shpërndarjes, një taksë standarde të kyçjes e që përcaktohet në pajtim me Metodologjinë e Tarifave dhe në Metodologjinë e Taksave për Kyçje;
- d) instalimin e njehsorëve të përshtatshëm të kërkuar që mundësojnë matjen e energjisë elektrike ose ngrohjes nga operatori i sistemit, në pikat hyrëse dhe dalëse;
- e) instalimin e ndërprerësve ose pajisjeve tjera të tilla sipas kërkesës;
- f) instalimin e njehsorëve specialë, të telemetrisë ose pajisjeve për procedim të dhënavë me qëllim që t'i mundësohet çdo aplikanti i cili është i detyruar që ti ketë këto s'pajisje, për të qenë në përputhje me Rregullat e Tregut.

8.3 Përveç kritereve të përcaktuar në Nenin 8.2, në rastet e kyçjes në rrjetin e shpërndarjes së ngrohjes, oferta për kyçje duhet të përbajë gjithashtu kushtet teknike të kyçjes të cilat i bashkëngjiten ofertës dhe të cilat duhet të përcaktojnë:

- a) parametrat teknik të sistemit të ngrohjes qendrore;
- b) vendndodhjen e nënstacionit brenda ndërtëses së konsumatorit, duke specifikuar pikën e kyçjes dhe mënyrën e kyçjes në tubacionin e furnizimit;
- c) kufijtë e pronësisë së instalimit brenda nënstacionit;
- d) rrjedhjen e projektuar të fluidit bartës të ngrohjes dhe tabelat e rregullimit;
- e) kriteret që kanë të bëjnë me nënstacionin për sa i përket kritereve specifike të ndërtimit për nënstacionet, dhe specifikimi i pajisjeve të nënstacionit dhe vendndodhjet e valvuleve për kontrollin e rrjedhjes, njehsori i ngrohjes dhe njehsori për ujin e trajtuar që furnizon sistemin dytësor.
- f) kriteret në lidhje me instalimin e brendshëm të ngrohjes.

8.4 Në përpilim të një oferte të marrëveshjes për kyçje ose të një përgjigje ndaj një aplikacioni për kyçje, operatori i sistemit duhet të vendosë:

- a) datën në të cilën punët e kërkuara për lejim të qasjes në rrjet duhet kompletuar,
- b) taksat që duhet paguar në lidhje me shërbimet e kërkuara duhet të paraqitën në mënyrë të atillë që të përputherford me metodologjinë e taksave për kyçje



- c) si dhe kushtet tjera të detajuara në respekt të çdo shërbimi të kërkuar siç janë ose mbase do të jenë të përshtatshme për qëllim të marrëveshjes.
- 8.5 Për qëllim të përcaktimit dhe taksimit të një përqindjeje të përshtatshme të kostove që janë hasur direkt ose indirekt nga aplikanti gjatë kryerjes së punëve sipas marrëveshjes për sigurimin e kyçjes ose ndryshimin e një kyçjeje ekzistuese, operatori i sistemit duhet të marrë parasysh masën me të cilën:
- a) përfitimi nga kyçja do të jetë në dispozicion të tjerëve, shfrytëzuesve të tanishëm dhe/ose të ardhshëm të sistemit, palëve të treta të cilat shërbehen nga operatori i sistemit;
  - b) operatori i sistemit mund të mbledhë përqindjen e këtyre kostove prej shfrytëzuesve të sistemit të tanishëm dhe të ardhshëm ose prej palëve të treta, duke u bazuar në përfitimin e përmendur në paragrafin a);
  - c) tarifat për kyçje duhet të vilen mbi bazën e njëhershme, dhe duhet të paguhen përpara fillimit të punëve për kyçje.
- 8.6 Asnjë pagesë nuk do bëhet për përforcim të një rrjeti ekzistues nëse kërkesa për ngarkesë të re ose të shtuar nuk kalon (3) % të kapacitetit efektiv ekzistues në pikën përkatëse në rrjet; dhe përforcimi i kryer në më shumë se në një nivel të tensionit më lartë se tensioni i kyçjes.
- 8.7 Oferta për kyçje duhet të lëshohet dhe dërgohet te konsumatori përmes furnizuesit brenda kohës, duke mos tejkaluar:
- a) tridhjetë (30) ditë kalendarike prej datës së dorëzimit të aplikacionit për kyçje në rrjetin me tension të ulët;
  - b) nëntëdhjetë (90) ditë kalendarikë prej datës së dorëzimit të aplikacionit për kyçje në rrjetin me tension të mesëm ose të lartë;
  - c) tridhjetë (30) ditë kalendarike prej datës së dorëzimit të aplikacionit për kyçje në rrjetin e shpërndarjes së ngrohjes.
- 8.8 Në rast të vendosjes së kyçjes për një konsumator të privilegjuar, oferta dhe marrëveshja për kyçje mund të nxirret dhe të dorëzohet pa përfshirë furnizuesin. Konsumatori i privilegjuar në atë rast mund të nënshkruajë Marrëveshjen për Hyrje, e cila vendos detyrim për t'u përputhur me Rregullat e Tregut. Përpresa nënshkrimit të Marrëveshjes për Hyrje, konsumatori i privilegjuar është i detyruar të marrë Licencën e Furnizimit/Tregtimit nga ZRRE-ja.
- 8.9 Afati i fundit për dorëzim të ofertës për kyçje mund të zgjatet në rast të ndonjë kyçje të vështirë që lë të nënkuptohet një studim paraprak teknik për zgjerim të rrjetit ose të çfarëdo arsyë të thjeshtë në përputhje me dispozitat e kodit të rrjetit dhe shpërndarjes ose kodeve tjera të aplikueshme. Në këto raste, studimi duhet të përfundohet brenda nëntëdhjetë (90) ditësh kalendarike prej ditës së dorëzimit të aplikacionit për kyçje dhe oferta për kyçje duhet të dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditësh prej përfundimit të studimit përkatës.



- 8.10 Në rast të një kontesti në lidhje me kushtet e ofertës për kyçje, Metodologja e Taksave për Kyçje, do të bëjë të mundur që aplikanti të bëjë vetë studimin teknik me shpenzimet e veta, dhe që operatori i sistemit të bëjë të mundur lehtësimin e një studimi të tillë përmes dhënies së informacioneve të nevojshme për të cilët mund të vendoset një taksë e përshtatshme.

**Neni 9**  
**Refuzimi për Kyçje**

- 9.1 Operatori i sistemit mund të refuzoj të kyçë një aplikant përkohësisht ose përherë vetëm nëse ajo kyçje është teknikisht dhe ekonomikisht jo e mundshme në përputhje me dispozitat e kodit të rrjetit dhe shpërndarjes ose kodeve tjera të aplikueshme.
- 9.2 Në këtë rast një njoftim në formë të shkruar që identifikon arsyen e refuzimit duhet të lëshohet dhe dërgohet te aplikuesi brenda kohës që nuk tejkalon tridhjetë (30) ditë kalendarike prej datës së dërgimit të aplikacionit, përkatësisht brenda afatit përfundimtar të përcaktuar në Nenin 8.9.
- 9.3 Në këtë njoftim operatori i sistemit duhet ti referohet mundësisë së kyçjes në të ardhmen në përputhje me planin zhvillimor të rrjetit, nëse është e aplikueshme.

**Neni 10**  
**Marrëveshja për Kyçje**

- 10.1 Brenda periudhës kohore të specifikuar në ofertën për kyçje, aplikanti pranon ofertën duke i dërguar furnizuesit draft marrëveshjen e nënshkruar për kyçje sipas Nenit 33.8 dhe 33.9, dhe paguan tarifat përkatëse për kyçje në përfitim të operatorëve të aplikueshëm të sistemit.
- 10.2 Marrëveshja për kyçje duhet të bëhet në ditën e dërgimit të draftit të nënshkruar të marrëveshjes për kyçje te operatori i sistemit.
- 10.3 Marrëveshja për kyçje duhet të:
- përfshijë parimet themelore të vendosura në Nenin 6;
  - përbajë elementet sipas Nenit 8;
  - përfshijë afatet në lidhje me fillimin, taksat dhe kushtet e pagesave, ndërprerjen dhe kontestet;
  - përfshijë standardet minimale të sigurisë;
  - përbajë kriteret minimale të sigurisë përfshirë kriteret në lidhje me vulosjen e pajisjeve matëse dhe mbylljen me dry të vendit ku janë instaluar ndërprerësit, pajisjet matëse, transformatorët dhe qarqet matëse;
  - dispozitat e përshkruara sipas paragrafëve d) dhe e) do të aplikohen menjëherë sa po të
  - hyjnë në fuqi kodet teknike të parashikuara në Ligjin mbi Energjinë Elektrike.



**Neni 11**

**Kyçja**

- 11.1 Me përfundimin e marrëveshjes për kyçje, operatori i sistemit duhet të vendos kyçjen siç është specifikuar në atë marrëveshje.
- 11.2 Me vendosjen e kyçjes, operatori i sistemit duhet të lëshoj një raport duke konfirmuar që kyçja është bërë në përputhje me afatet dhe kushtet e marrëveshjes për kyçje, dhe atë raport ta paraqesë te shfrytëzuesit e sistemit.
- 11.3 Kyçja e shfrytëzuesve fundor e vendosur duke përfillur procedurat e lartshënuara do të mbetet e vlefshme në rastet të çdo ndryshimi të statusit të furnizuesit nëse marrëveshja për kyçje nuk është e ndërprerë.
- 11.4 Kyçja e një konsumatori do të aktivizohet (lëshohet) vetëm me udhëzimin e shkruar nga furnizuesi dhe dërguar te Operatorit i Sistemit, se është nënshkruar Marrëveshja për Furnizim dhe janë plotësuar të gjithë kriteret për furnizim.
- 11.5 Mirëmbajtja e elementeve të kyçjes së thellë do të jetë përgjegjësi e Operatorëve të Sistemit të Transmisionit dhe Shpérndarjes dhe do të kryhet pa asnje pagesë shtesë nga ana e konsumatorëve. Operatori i Sistemit do të jetë i autorizuar të vendosë një tarifë të përshtatshme fillestare për kostot e kapitalizuar të mirëmbajtjes së kyçeve të cekëta që aplikohen në mënyrë jo-diskriminuese ndaj të gjithë shfrytëzuesve të këtyre kyçeve.
- 11.6 Neni 11.5 nuk do të aplikohet ndaj kyçeve ekzistuese që janë në pronësi të konsumatorëve. Për mirëmbajtjen e këtyre kyçeve, operatorët e sistemit do të ngarkojnë konsumatorët në mënyrë të vazhdueshme sipas çmimores së aprovuar nga ZRRE-ja, dhe me tarifa të cilat do të mund të rregullohen në mënyrë të përshtatshme. Sipas këtij Neni, mirëmbajtja e kyçjes përfshin mirëmbajtjen e kabllove/telave të lidhur në rrjetin e operatorit, aparaturat matëse dhe siguresat hyrëse (nëse aplikohen) të kutive matëse. Kjo do të mund të kryhet vetëm nga Operatorët e Sistemit të Transmisionit ose Shpérndarjes.
- 11.7 Konsumatorët që kanë në pronësi të tyre pika kyçje, përfshirë aparaturat matëse, mund t'i transferojnë asetat e tyre tek operatorët e sistemit pa asnje kompensim pas sjelljes së tyre në gjendje të mirë, siç kërkohet në kodet teknike të nxjerrë nga operatorët e sistemit dhe aprovuar nga ZRRE-ja. Prej datës kur do të bëhet transferimi i këtyre aseteve nga konsumatorët, do të aplikohen dispozitat e Nenit 11.5. Asetet e transferuara do të përfshihen në bazën e aseteve të operatorit të sistemit që shfrytëzohet për qëllimet e aprovimit të tarifave të rregulluara nga ZRRE-ja, në përputhje me parimet e përcaktuara në Metodologjinë e Tarifave.
- 11.8 Në rast të qëllimit të konsumatorëve për të shfrytëzuar dispozitën e Nenit 11.6, operatori i sistemit mund të kërkojë rregullimin e tarifës në përputhje me Rregullin mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike. Transferimi i mundshëm i aseteve që



përcaktohet në Nenin 11.7, do të merret në shqyrtim në përputhje me Metodologjinë e Tarifave për Sektorin e Energjisë të aprovuar nga ZRRE.

## KAPITULLI 4 SHFRYTËZIMI I SISTEMIT

### Neni 12 Parimet Themelore të Kostove të Shfrytëzimit të Sistemit

Taksat për shfrytëzim të sistemit janë të parashikuara në Kapitullin 22 të Rregullave të Tregut dhe të përcaktuara nga parimet e llogaritjes në Rregullin mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulla e Çmimeve) dhe Metodologjinë e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe taksat për balancim si dhe për shfrytëzim të shërbimeve ndihmëse.

### Neni 13 Hyrja në Shfrytëzim të Sistemit

- 13.1 Me qëllim të qasjes në shfrytëzim të sistemit, Pala Aplikuese ose do të jetë nënshkruese e Marrëveshjes Kornizë, ose do të nënshkruejë Marrëveshjen për Hyrje me Operatorin e Tregut në rolin e vet si Palë e Autorizuar sipas Marrëveshjes Kornizë (tani e tutje “Pala e Autorizuar”).

### Neni 14 Marrëveshja Kornizë

- 14.1 Palët e Autorizuara do të nënshkruanë Marrëveshjen Kornizë me të cilën Rregullat e Tregut bëhen obliguese në mes palëve në atë marrëveshje.

## KAPITULLI 5 KONTRATAT PËR FURNIZIM

### Neni 15 Aplikimi për Furnizim

- 15.1 Një aplikacion për furnizim duhet të dorëzohet nga konsumatorët tek furnizuesi me qëllim që të lidhet kontrata për furnizim.
- 15.2 Konsumatorëve u kërkohet një aplikacion për furnizim në rast se ata ndryshojnë furnizuesin. Në rastet kur konsumatorët nuk kërkojnë zgjerim të kapacitetit të kyçjes, ata nuk kanë nevojë t'u përmbahen dispozitave të Neneve 7 dhe 8 të kësaj Rregulle. Në rast se konsumatori nuk është në përputhje me kriteret komerciale minimale të sigurisë dhe mbrojtjes që janë përshkuar në Nenet 7, 8, 10 dhe 11 të kësaj Rregulle, kyçja ekzistuese do të shkyçet në një datë të dakorduar që do t'i mundësojë konsumatorit të bëjë një kyçje të re alternative në



përputhje me kriteret. Forma e aplikacionit për ndërrimin e furnizuesit do t'i shtohet më vonë kësaj Rregulle.

- 15.3 Aplikacionet për furnizim duhet të bëhen në përputhje me formën standarde të përshkruar në Shtojcën A, së bashku me dokumentet e këruara. Furnizuesi është i obliguar që të regjistroj çdo aplikacion për furnizim.
- 15.4 Furnizuesi shqyrton, aplikacionin brenda tridhjetë (30) ditëve prej datës së pranimit dhe nxjerr njoftim me shkrim në lidhje me synimin e vet për të pranuar ose refuzuar aplikacionin. Ky afat kohor mundet të zgjatet për (15) ditë kalendarikë të tjera në rastet kur kërkohen informata shtesë. Aplikuesi duhet të informohet rreth këtyre zgjatjeve me shkrim.
- 15.5 Furnizuesi duhet të zhvillojë dhe paraqesë për aprovim te ZRRE-ja politikat në lidhje me kriteret për aplikuesit ose konsumatorët që të demonstroj aftësi pagesë të kënaqshëm për shërbime të reja ose shërbime në vazhdim, përfshirë çfarëdo kërkese ose marrëveshje për pagesën e një depozite garancie sipas Nenit 23. Një aplikim për shërbim mund të refuzohet nëse aplikuesi nuk është në gjendje të paraqesë aftësi pagesë të pranueshme sipas kësaj Rregulle dhe politikave të aprovuara nga Bordi i ZRRE-së.
- 15.6 Nëse një aplikuesi i refuzohet shërbimi, aplikuesi mund të fillojë zgjidhjen e kontesteve në përputhje me Rregullin për Zgjidhjen e Kontesteve. Nëse refuzimi vjen nga operatori i sistemit, furnizuesi mund të inicioj zgjidhje të kontestit në vend të konsumatorit, në përputhje me Nenin 6.2.

**Neni 16**  
**Kontrata për Furnizim**

- 16.1 Kontrata për furnizim do të bëhet ngashëm si në Shtojcën C, e cila i nënshtrohet modifikimeve ose plotësimeve që mund të propozohen nga furnizuesi dhe të pranohen nga konsumatori.
- 16.2 Kontrata për furnizim hyn në fuqi dhe kyçja do të lëshohet nga operatori i sistemit brenda një periudhe kohore e cila nuk i tejkalon pesë (5) ditë kalendarike prej datës së nënshkrimit nga furnizuesi dhe konsumatori, pas së cilës do të vijojë njoftimi i pranimit të kyçjes nga operatori i sistemit. Ky i fundit do të vërtetojë përputhshmérinë me kriteret e kyçjes.
- 16.3 Konsumatorit dhe operatorit të sistemit do t'u komunikohet me shkrim data e fillimit të kontratës përfshirë konsumatorin. Përfshirësuesi i autorizuar i operatorit të sistemit do të bëjë një lidhje të re, ose do të bëjë përmirësimin e lidhjes me anë të një udhëzimi me shkrim nga ana e furnizuesit. Pozitat e njehsorëve do të dakordohen nga përfshirësuesi i furnizuesit, operatori i sistemit dhe konsumatori në pajtim me standartet teknike dhe kodet relevante.
- 16.4 Për modifikimin e kontratave ekzistuese përfshirë konsumatorin do të aplikohet procedura e vendosur në Nenin 15, sipas Nenit 8.



**Neni 17**  
**Marrëdhënia Kontraktuese në Rastet e Furnizimit me Ngrohje**

- 17.1 Në ngrohjen qendrore, konsumatori - pala kontraktuese konsiderohet pronari ose shfrytëzuesi i autorizuar i ndërtesës së pajisur me nënstacion dhe me rrjet dytësor të ngrohjes së brendshme.
- 17.2 Në rast të ndërtesave me shumë kate të cilat përbëhen nga apartamente të shumta në pronësi individësh të cilët janë shfrytëzuesit fundorë të ngrohjes, konsumatori – pala kontraktuese e furnizuesit – do të konsiderohet një entitet ligjor që përmblush detyrat e veta të administrimit shtëpiak (p.sh. administrator, shoqata banesore, etj.) i cili do të krijohet në të ardhmen.
- 17.3 Deri në krijimin e administratës banesore në ndërtesat shumëkatëshe, çdo pronar i apartamenteve do të konsiderohet si një konsumator– palë kontraktuese e furnizuesit.

**Neni 18**  
**Obligimi për Furnizim**

- 18.1 Çdo furnizues publik është i detyruar që të furnizojë me energji çdo konsumator jo të privilegjuar që gjendet në zonën e mbuluar nga i licencuari për furnizim, dhe që është i kyçur në rrjet në përputhje me marrëveshjen për kyçje dhe në bazë të dispozitave të kontratës për furnizim, dhe duke ju nënshtuar kritereve të Neneve 7, 8, 10 dhe 11, përvèç në rastet sipas Nenit 15.2.
- 18.2 I njëjtë detyrim vlen për furnizimin e konsumatorëve të privilegjuar që, për çfarëdo arsyje, nuk furnizohen më nga furnizuesit e përzgjedhur dhe duan të furnizohen nga furnizuesit publik në përputhje me Rregullën mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë. Për tu furnizuar konsumatori i privilegjuar ai duhet të ju nënshtrohet kritereve të Neneve 7, 8, 10 dhe 11.

**KAPITULLI 6**  
**QASJA NË PRONË**  
**Neni 19**

- 19.1 Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të operatorit të rrjetit/furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 27 dhe 28 të Ligjit për Energi.
- 19.2 Nëse konsumatori nuk lejon qasje për leximin e pajisjeve matëse edhe pas marrjes së njoftimit me shkrim, energjia e furnizuar do të faturohet sipas shfrytëzimit në periudhat paraprake krahasuese siç përcaktohet në Nenin 19.5 të Rregullës mbi Shkyçjen dhe Rikyçjet e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, ose në përputhje me sasinë e energjisë që



është rënë dakord të furnizohen gjatë periudhave përkatëse, të cilat nuk mund të jenë më pak se sasitë e parashikuara në marrëveshje.

- 19.3 Refuzimi i paarsyeshëm dhe i vazhdueshëm i konsumatorit që ti lejoj qasje në pronë ndërmarrjes së energjisë, mund të dënohet sipas dispozitave të Rregullës për Shkyçje dhe Rikyçjet të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë .

## **KAPITULLI 7** **MATJA, FATURIMI DHE PAGESAT**

### **Neni 20** **Leximi i Njehsorëve**

- 20.1 Operatori i sistemit mund t'ia besojë leximin e njehsorëve furnizuesve ose ndonjë kontraktuesi tjetër. Në këtë rast, entiteti i kontraktuar për leximin e njehsorëve, është i detyruar të sigurojë lexim të rregullt dhe të saktë të njehsorëve, në përputhje me Kodin Matës.
- 20.2 Pas kërkesës së konsumatorëve personi që i referohet Neni 20.1, është i obliguar që t'i siguroi atij çfarëdo informate në lidhje me rezultatet e leximit të njehsorëve.

### **Neni 21** **Testimi i Njehsorëve**

- 21.1 Me rastin e kërkesës së furnizuesit ose të konsumatorit, sipas rastit, dhe kur çdo herë është e nevojshme, operatori i sistemit është i obliguar të testoj njehsorët. Testimi dhe procedura e testimit të njehsorëve janë të përcaktuara në Kodin Matës.
- 21.2 Në rast se funksioni i furnizuesit dhe operatorit të sistemit kryhet nga i njëjtë entitet, ky i fundit është i detyruar të testojë njehsorin sipas kërkesës së konsumatorit.
- 21.3 Operatori i sistemit do të jetë i detyruar t'i sigurojë furnizuesve çdo rezultat në lidhje me saktësinë e njehsorëve të testuar, që nëse është e aplikueshme të bëjë reklamimin e humbjeve komerciale, në përputhje me parimet përkatëse Rregulle dhe me Rregullën mbi Shkyçjen dhe Rikyçjet e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë dhe Metodologjinë e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike, të paraqitur nga Operatori i Sistemit të aprovuar nga ZRRE-ja.

### **Neni 22** **Faturimi**

- 22.1 Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat të tjera, në përputhje me llojin e duhur të tarifës të dakorduar me konsumatorin (nëse është e aplikueshme).



- 22.2 Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet në bazë tarifave të aprovuara nga ZRRE-ja e në përputhje me Rregullin mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulli i Çmimeve) dhe duke u bazuar në të dhënrat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga furnizuesi ose operatori i rrjetit për çdo periudhë të faturimit ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim.
- 22.3 Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, furnizuesi do të bëjë të gjithë rregullimet e nevojshme në faturën vijuese. Mundet që faturimi i pasaktë të shkaktohet nga më shumë faktorë sesa "leximi i pasaktë i njehsorëve".
- 22.4 Faturat dërgohen në adresën e konsumatorit që është specifikuar në kontratën për furnizim. Nëse nuk është specifikuar adresa ose është specifikuar në mënyrë të pasaktë ose të paplotë, ose nëse konsumatori nuk gjendet më në adresën e specifikuar, furnizuesi do ta bëjë dërgesën në vendndodhjen fizike ku ka ndodhur shfrytëzimi i energjisë. Nëse konsumatori vazhdon me mospagesë, sipas Kontratës për Furnizim, me kërkesë të furnizuesit operatori i sistemit do të shkyçë konsumatorin nga rrjeti, në përputhje me Rregullën mbi Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, që është aprovuar nga ZRRE-ja.
- 22.5 Kurdo që është e arsyeshme, furnizuesi mund të kryejë dërgesën e faturës ose të njoftojë duke dërguar me postë faturën në një lokacion që shihet apo në fqinjësinë e menjëhershme të lokacionit fizik ku ka ndodhur shfrytëzimi i energjisë.
- 22.6 Faturat mund të ndajnë pagesën për energjinë e shfrytëzuar prej të gjitha pagesave tjera, duke përfshirë pagesat për shfrytëzim të rrjetit. Furnizuesi duhet të paraqesë një formë standarde dhe përbajtje standarde të faturave te Bordi i ZRRE-së për rishikim dhe aprovim para se të dërgohen te konsumatorët.

**Neni 23**  
**Depozitimi i Garancisë**

- 23.1 Në rastin e konsumatorëve komercial dhe konsumatorëve familjarë, të cilët nuk kanë qenë të rregullt në pagesa, furnizuesi ka të drejtë të kërkojë për depozitim të garancisë.
- 23.2 Depozitimi i Garancisë përbëhet nga një garanci e përshtatshme e cila mbulon taksat e ardhshme për furnizimin me energji dhe përbëhet nga një e gjashta e vlerës së faturimit të parashikuar për dy mbëdhjetë (12) muaj sipas tarifave që janë në fuqi në atë periudhë. Depozita e garancisë duhet të mbulojë taksat e ardhshme të parashikuara për një periudhë prej dy (2)muajsh.
- 23.3 Depozitimet e garancisë duhet të paguhen me para në dorë ose përmes xhirologarisë bankare.
- 23.4 Depozitimet e garancisë duhet ti kthehen konsumatorit pas ndërprerjes së kontratës për furnizim dhe pas rregullimit të borxhit të papaguar, nëse është ndonjë, brenda periudhës njëmujore që nga data e ndërprerjes.



**Neni 24**  
**Pagesa e Faturave**

- 24.1 Pagesa e Faturave dhe depozitimet e garancisë duhet të bëhen me para në dorë në qendrën e specifikuar për arkëtim te furnizuesi, çdo ditë të punës gjatë orëve të përshkruara, ose me ndonjë mjet tjetër të specifikuar në faturë apo në kontratën përfshirë furnizim.
- 24.2 Në rast të çfarëdo pagesë që i bëhet operatorit të sistemit përfshirë shërbim, konsumatorit duhet t'i lëshohet një dëftesë nga furnizuesi. Marrësi i pagesës do të mbajë një regjistër përfshirë paktën tre (3) vjet, në lidhje me pagesat, informacionet mbi pagesat dhe shënimet në lidhje me arsyen e pagesës dhe prej kujt është bërë pagesa.
- 24.3 Furnizuesit duhet të krijojnë dhe paraqesin procedurat përfshirë faturim të konsumatorëve te ZRRE-ja përfshirë shqyrtim dhe aprovim.
- 24.4 Procedura duhet të përmbarë periudhën prej datës së dorëzimit të faturës gjer me datën e afatit të fundit të pagesës, si dhe periudhën pas afatit të lejuar para se të aplikohet kamata përfshirë pagesë sipas Nenit 25.
- 24.5 Periudha e arritjes së borxhit prej dorëzimit të faturave te konsumatorët përfshirë gjitha pagesat aktuale nuk duhet të jetë më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë.
- 24.6 Periudha e lejuar pas afatit të fundit kohor para aplikimit të çfarëdo kamate ose interesu nuk do të jetë më pak se njëzetë (20) ditë prej datës së kalimit të afatit të fundit përfshirë pagesë.
- 24.7 Mos-pranimi i faturës nuk e liron konsumatorin nga obligimi përfshirë paguar.
- 24.8 Dorëzimi i çdo ankesë në lidhje me saktësinë e faturës nuk do të suspendoj obligimin e konsumatorit që të paguar faturën, në të cilin rast konsumatorit do ti kërkohet që të bëj pagesën në përpjekje me Artikullin 19.5 të Rregullës përfshirë Shkyçje dhe Rikyçjet të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.

**Neni 25**  
**Pasojet e Mos-Pagesave**

- 25.1 Në rast të mos pagesës furnizuesi ka të drejtë që të rregulloj borxhet e pagueshme nga konsumatori prej depozitimit garantues në çdo kohë. Në raste të tillë, furnizuesi mund të kërkoj nga konsumatori që të bëjë një depozitë garantues shtesë.
- 25.2 Në rast të mos pagesës brenda periudhës së lejuar, siç përcaktohet në Nenin 24.6, konsumatori është i detyruar të paguajë kamatë përfshirë shumën e borxhit në normë të caktuar përfshirë muaj, pa paragjykim ndaj të drejtës së furnizuesit përfshirë vënë gjoba përfshirë mospagim, sipas çdo klauzole të gjobave të përfshirë kontratën përfshirë furnizim. Normat e interesit do të aprovohen nga ZRRE përfshirë çdo vit fiskal sipas kërkësës së furnizuesit.



- 25.3 Me vendim të furnizuesit këstet mujore për qëllim të shlyerjes së borxhit mund të dakordohen me konsumatorin, pa paragjykuar detyrimin e konsumatorit që të paguaj kamatat deri në shlyerjen e plotë të borxhit.
- 25.4 Për t'iu shmangur dyshimit, furnizuesi do të ketë poashtu në disponimin e tij të gjitha mjetet tjera të disponueshme nën Ligjin e Zbatueshëm, duke përfshirë por jo edhe kufizuar të drejtën për të mbuluar realizimin dhe kostot tjera për çfarëdo aktesh, të drejtën për pengim si garanci pagese në çfarëdo prone të konsumatorit dhe të konfiskojë çfarëdo asetesh dhe t'i bashkëngjis llogaritë bankare të konsumatorit apo pagën apo pagesat tjera.
- 25.5 Furnizuesi mund të transferoj të dhënat institucioneve tjera me qëllim të përmirësimit të normës së arkëtimit ose me kërkesë, t'i dërgojë institucioneve të autorizuara në pajtim me Ligjet e aplikueshme. Në rast të transferimit ose dërgimit të dhënavë të konsumatorëve furnizuesi duhet t'i përbahet të drejtës së konsumatorit për konfidencialitet të parashikuar nga legjislacioni i aplikueshëm.

**Neni 26**  
**Shkyçja për Mos-Pagesë**

Shkyçja për mos pagesë mund të zbatohet vetëm si masë e fundit sipas dispozitave të Rregullës për Shkyçje dhe Rikyçjet të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.

**Neni 27**  
**Regjistrimet në lidhje me Kontratat për Furnizim**

Furnizuesit janë të detyruar që të mbajnë regjistra me informacionet përkatëse të:

- a) marrëveshjeve të nënshkruara për kryje për konsumatorët sa herë që kërkohet të kenë një marrëveshje përvèç kontratës për furnizim;
- b) aplikacionet e paraqitura për furnizim;
- c) aplikacionet për modifikim (përmirësimit të kapacitetit ose ndryshimit të grupit tarifor) të kontratave për furnizim;
- d) kontratat për furnizim të lidhura, të ndryshuara dhe të ndërprera;
- e) faturimin, ndërprerjet e programuara dhe aksidentale në furnizim dhe përshtatja me f)
- f) kérkesat për kualitet;
- g) çdo e dhënë tjetër përkatëse në përputhje me dispozitat e Rregullave tjera të aplikueshme.



## KAPITULLI 8

### SHFRYTËZIMI I PAAUTORIZUAR I ENERGJISË

#### Neni 28

##### Shfrytëzimi i pa kontraktuar, Vjedha, Abuzimi i njehsorit dhe ndërhyrjet në kyçje

28.1 Konsumatori do të konsiderohet se shfrytëzon energji në mënyrë të **pa kontraktuar** nëse:

- a) Shfrytëzon energji në një mënyrë ose në sasi që nuk është si ajo që i është miratuar nga ndërmarrja e energjisë, dhe kjo mënyrë e marrjes së energjisë shkakton çregullime apo ndërprerje të furnizimit të konsumatorëve tjera;
- b) dështon të zbatojë specifikimet e nxjerra nga ndërmarrja e energjisë dhe nga Kodet relevante të cilët aplikohen varësish nga rasti, në lidhje me vendosjen dhe funksionimin e pajisjes së një konsumatori, dhe kyçjen e kësaj pajisjeje në instalimet elektrike ose të ngrohjes qendrore;
- c) transmeton energji pas pikës matëse, në një vend tjetër, pa lejen e ndërmarrjes së energjisë, dhe ia përçon një shfrytëzuesi tjetër në një vend të ndryshëm nga vendi i kyçjes në rrjetë, apo transmeton energji te një konsumator që i takon një grupi tjetër tarifor;
- d) nuk vepron në përputhje me kufizimet e konsumimit, sipas termave të Kushteve të Përgjithshme të Furnizimit me Energji; ose
- e) nuk nënshkruan konratën me furnizuesin e energjisë elektrike brenda afatit të dhënë dhe vazhdon të shfrytëzojë energjinë elektrike pa konratë.

28.2 Një konsumator do të konsiderohet se ka abuzuar njehsorin apo ka ndërhyrë në kyçje me qëllim për të vjedhur energji, në rast se ai:

- a) me vullnet ose me neglizhencë dëmton njehsorin ose pajisjet matëse, heq vlat e njehsorit, dhe nuk i raporton ndërmarrjes së energjisë me shkrim për ndonjë dëmtim;
- b) bënë veprime abuzive në njehsor apo ndërhyrjet në kyçje e që kanë për qëllim zvogëlimin e regjistrimit të sasisë së energjisë, apo mos regjistrim e energjisë së shpenzuar. Llojet e abuzimeve me njehsor dhe ndërhyrjet në kyçje do të përcaktohen në procedurën e brendshme të ndërmarrjes së energjisë.

28.3 Një konsumator do të konsiderohet se ka shfrytëzuar energji duke vjedhur nëse:



- a) merr energji pa lejen e ndërmarrjes së energjisë (konsumator i paregjistuar në ndërmarrjen e energjisë sipas kushteve për kyçje dhe për regjistrim, të përcaktuara në këtë Rregull),
  - b) merr energji duke bërë tejkalimin e pikës matëse
- 28.4 Konsumatorët nuk duhet të ndryshojnë ose kryejnë ndonjë veprim në kyçje, pajisje matëse dhe aparate pa pëlqimin me shkrim nga ndërmarrja e energjisë, dhe janë të obliguar që të raportojnë te furnizuesi apo te kuptojnë për ndonjë prishje të shkaktuar në kyçje dhe në pajisjet matëse.
- 28.5 Ndërmarrja e energjisë është e obliguar që të përgjigjet në kërkesën e konsumatorit në pajtim me Rregullat në fuqi, dhe është e obliguar për të bërë kyçjen, pranimin e pajisjes matëse, vendosjen e pajisjes matëse, vulosjen e pajisjes matëse, si dhe, kur kërkohet nga konsumatori apo shërbimi i caktuar, ndërrimin e pajisjes matëse.

**Neni 29**  
**Llogarita e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë**

- 29.1 Nëse fillimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë sipas Nenit 28.2 dhe 28.3 nuk mund të përcaktohet, për konsumatorët familjar do të merret që shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë ka filluar gjashtë (6) muaj, ndërsa që për konsumatorët tjerë dymbëdhjetë (12) muaj para datës kur konsumatori është zbuluar duke bërë shfrytëzim të paautorizuar të energjisë, ose nga dita e inspektimit të fundit kur instalimi ka qenë në rregull.
- 29.2 Për llogaritjen e faturave për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë do të zbatohen tarifat e aplikueshme në datën kur është zbuluar shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë, gjegjësisht në datën e përpilimit të procesit nga ekipi i kontrollës, dhe për konsumatorët familjar do të zbatohen tarifat e grupit një-tarifor të ndara sipas sezoneve (verë, dimër), kurse për konsumatorët tjerë do të zbatohen tarifat më të larta, gjithashtu të ndara sipas sezoneve.
- 29.3 Ndërmarrja e energjisë (Furnizuesi/OSSH-ja) duhet të paraqesë për aprovim në ZRRE procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë sipas Nenit 28. Në këtë procedurë duhet të specifikohen:
- a) llojet e abuzimeve në njehsor dhe ndërhyrjeve në kyçje sipas Nenit 28.2 (b), dhe veprimet që duhet të ndërmarrë ndërmarrja e energjisë për secilin lloj abuzimi të njehsorit dhe ndërhyrjeve në kyçje;
  - b) veprimet që duhet të ndërmarrë ndërmarrja e energjisë në rast të shfrytëzimit të pa kontraktuar të energjisë sipas Nenit 28.1; dhe
  - c) mënyra e llogaritjes së energjisë së shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar sipas Nenit 28.1 dhe Nenit 28.2, të ndara sipas grupeve tarifore të aprovuara nga ZRRE.



- 29.4 Gjatë llogaritjes së energjisë të shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar sipas Nenit 29.3, c) furnizuesi duhet të zgresë nga fatura e rikthimit të humbjeve energjinë e faturuar gjatë asaj periudhe (nëse ka faturuar).
- 29.5 Pa paragjykuar në kompetencat e ZRRE-së për të vënë gjoba sipas Nenit 57 të Ligjit për Rregulatorin e Energjisë dhe ndaj çdo detyrimi penal ose civil, çdo dëm i shkaktuar nga aktivitetet e lartpërmendura mund të gjobitet sipas dispozitave të Rregullës për Shkyçje dhe Rikyçjet të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë .

**Neni 30**

**Kompensimi i Konsumatorëve në Gjendje të Mirë**

- 30.1 Në rast se furnizuesi dështon të përcjellë procedurat për shkyçje të vendosura në Rregullën për Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, konsumatorët e prekur negativisht të cilët janë të rregullt në pagesën e faturave kanë të drejtë në kompensim prej furnizuesit për dëmet direkte dhe të provuara të pranuara si rezultat nga kjo.
- 30.2 Furnizuesi duhet të paraqesë për rishikim dhe miratim në ZRRE procedurat për kompensime të tillë.

**KAPITULLI 9**

**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

**Neni 31**

**Gjuha Zyrtare e Rregullit**

Kjo Rregull është nxjerr në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze. Në rast të ndonjë kundërthënie, versioni në gjuhën Shqipe do të dominojë.

**Neni 32**

**Amendmentet – Paneli për Furnizim me Energji**

- 32.1 ZRRE-ja mund të ndryshojë këtë Rregull nëse e konsideron të nevojshme. Ndërmarrjet e energjisë janë të obliguara që të informojnë konsumatorët për amendmentet e kësaj Rregulle në mënyrë të duhur dhe me të gjitha mjetet e duhura.
- 32.2 ZRRE-ja mund të themelojë një Panel për Furnizimin me Energji, si organ me rëndësi i krijuar për të shqyrtuar dhe diskutuar sugjerimet për amendmentet e kësaj Rregulle. Është në zgjedhjen e ZRRE së të vendosë pas sugjerimeve të bëra nga Paneli për Furnizim me Energji.



- 32.3 Paneli për Furnizim me Energji duhet të përfshijë konsumatorët ose përfaqësuesit e tyre gjithashtu përfaqësuesit e furnizuesve dhe çdo anëtar tjetër të përcaktuar nga ZRRE.

**Neni 33**  
**Dispozitat e Përkohshme**

- 33.1 Brenda periudhës një (1) mujore pas miratimit të kësaj Rregulle, furnizuesi publik në vend të konsumatorit duhet të paraqesë te operatorët e sistemit të bartjes dhe shpërndarjes një aplikacion për kycje të të gjithë konsumatorëve ekzistues.
- 33.2 Brenda periudhës së ardhshme kohore një (1) mujore pas paraqitjes së aplikacionit për kycje, furnizuesi publik duhet të implementojë dispozitat e Nenit 10 dhe të nënshkruajë me operatorin e sistemit një marrëveshje të vetme për kycjen e të gjithë konsumatorëve ekzistues. Përpara se kjo marrëveshje të hyjë në fuqi, operatorët e sistemit do të vazhdojnë të japid shërbime për konsumatorët ekzistues, me të njëjtat kushte dhe afate që kanë qenë në fuqi përpresa miratimit të kësaj Rregulle.
- 33.3 Brenda periudhës kohore gjashtë (6) mujore pas miratimit të kësaj Rregulle, furnizuesi i ngrohjes do të nënshkruaj me të gjithë konsumatorët kontratën përfurnizim.
- 33.4 Furnizuesi mund te sigurojë shërbime të përkohshme për konsumatorin dhe t'i kërkojë atij qe të bartë gjithë kostot e instalimit dhe heqjes së shërbimit që tejkalojnë çdo vlerë të rikuperuar. Kohëzgjatja e shërbimit te përkohshëm do të specifikohet në tarifat e aplikueshme të aprovuar nga ZRRE-ja.
- 33.5 Brenda periudhës kohore të vendosur në Nenin 32.1 furnizuesi duhet të paraqesë raportin te ZRRE-ja në pajtueshmëri me Nenin 38.3 ose Ligjin përf Energjinë Elektrike.
- 33.6 Në rastin e mos përbushjes së obligimeve, ZRRE ka autoritetin të vejë gjoba në përputhje me Nenin 57 të Ligjit përf Rregulatorin e Energjisë furnizuesit ose operatorit të sistemit përdështim në përbushjen e obligimeve të vendosura në këtë Rregull, Ligjin përf Energjinë Elektrike dhe Rregullave dhe legjislativë tjera të aplikueshme.
- 33.7 Operatori i sistemit të shpërndarjes në kohë sa më shpejtë që është e praktikueshme, por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, duhet të përgatisin Metodologjinë e Taksave përf Kyçje dhe t'ia dorëzojnë ZRRE-së përf aprovim.
- 33.8 Brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike pas miratimit të këtij Rregulli, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të dorëzojë në ZRRE formën standarde të: **Marrëveshjes përf Kyçje në Rrjetin e Shpërndarjes**



**Neni 34**

**Gjobat**

- 34.1 Në rastet kur furnizuesi nuk i përmbush obligimet e tij për nënshkrim të marrëveshjes për kyçje me operatorin e sistemit në vend të konsumatorit, ose nuk e furnizon konsumatorin në përputhje me kontratën përfurnizim, ZRRE ka autoritetin të vejë gjoba përfurnizuesin e tillë në përputhje me Nenin 57 të Ligjit përf Rregulatorin e Energjisë.
- 34.2 Neglizimi i dispozitave të caktuara në kontratën përfurnizim mund të lejohet në rastet kur furnizuesi paraqet te ZRRE-ja arsyen që mund të provojë paftësinë e përmbushjes të këtyre kërkesave dhe propozoj masat dhe veprimet që mund të largojnë këto pengesa.

**Neni 35**

**Hyrja në Fuqi**

- 35.1 Kjo Rregull hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
- 35.2 Dispozitat e çdo rregulloreje, urdhri apo rregulle të lëshuar para kësaj Rregulle dhe që nuk janë në pajtueshmëri me dispozitat e kësaj Rregulle do të zëvendësohen me efekt të menjëhershëm.
- 35.3 Me kërkesën e ndërmarrjeve të energjisë të cilat operojnë ne kohën e nxjerrjes së kësaj Rregulle, ZRRE-ja mund të bëj përjashtime ndaj obligimit përf t'u përshtatur me dispozitat specifike të kësaj Rregulle përfperiudhën e përcaktuar kohore. ZRRE-ja duhet të publikojë vendime të këtilla në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Dokumentet Referuese**

1. Kodi i Rrjetit.
2. Kodet Teknike dhe Operacionale.
3. Rregullat e Tregut.
4. Rregulla përf Procedurën e Zgjedhjeve së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.
5. Metodologjia e Taksave përf Kyçje.
6. Metodologjia e Tarifave përf Sektorin e Energjisë Elektrike
7. Kodi Matës

**Dokumentet Shtesë që nevojiten**

1. Ligji përf Rregulatorin e Energjisë
2. Ligji përf Energjinë Elektrike
3. Rregulli mbi Shkyçjen dhe Rikyçjet e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë



ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së:

Anëtarët e Bordit:



Ky aplikacion i nënshtrohet kritereve të:

1. Ligjit për Energjinë Elektrike
2. Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energi

#### SHTOJCA A: APLIKACIONI PËR KYÇJE DHE FURNIZIM

##### 1. Konsumatorët Familjar

Kyçje e Re/ Modifikim i një marrëveshje ekzistuese për kyçje  
(Ju lutem fshijeni qëllimin që nuk është i aplikueshëm)

Për (furnizuesin) Numri Regjistrues: \_\_\_\_\_

Kërkoj nga ju të kyçni objektin e përshkruar më poshtë në rrjetin elektrikë/ngrohjes. (Ju lutem fshijeni rastin që nuk është i aplikueshëm)

##### 1. Aplikuesi:

- a) Emri: \_\_\_\_\_
- b) Nr. i letërnjoftimit: \_\_\_\_\_
- c) Përfaqësuesi ligjor (nëse është e aplikueshme): \_\_\_\_\_
- d) Adresa: \_\_\_\_\_
- e) Nr. i telefonit: \_\_\_\_\_
- f) E-mail: \_\_\_\_\_
- g) Pronari/ shfrytëzuesi i autorizuar i objektit  
(Ju lutem fshijeni rastin që nuk është i aplikueshëm)

##### 2. Përfaqësues i aplikuesit:

- a) Emri: \_\_\_\_\_
- b) Përfaqësuesi ligjor (nëse është e aplikueshme): \_\_\_\_\_
- c) Adresa: \_\_\_\_\_
- d) Nr. i telefonit: \_\_\_\_\_
- e) E-mail: \_\_\_\_\_

##### 3. Përshkrimi i objektit për të cilin kërcohët kyça:

- a) Rruga: \_\_\_\_\_
- b) Nr: \_\_\_\_\_
- c) Qyteti/Fshati: \_\_\_\_\_
- d) Kodi postar: \_\_\_\_\_
- e) Pronari: \_\_\_\_\_
- f) Shfrytëzuesi i autorizuar i objektit (nëse është e aplikueshme): \_\_\_\_\_
- g) Zona e ndërtuar e objektit / ngastra: \_\_\_\_\_



**4. Shënimet teknike:**

Shfrytëzimi i tokës nga objektet që do të kyçen: Agrikulturë, Familjar dhe Komercial

- a) Kapaciteti ekzistues i aprovuar i lokacioneve (nëse është e mundshme). Kapaciteti i ri kërkohet me këtë aplikacion.  
Kapaciteti instaluar \_\_\_\_\_ kW
- b) Metrat katror të pronës \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>
- c) Përshkrimi i pronës:
  - Podrumi \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>
  - Dhoma e ditës \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>
  - Kuzhina \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>
  - Dhoma e fjetjes \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>
  - Të tjera \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>  
(për kalkulum të tarifës paushallë nëse kërkohet)
  - Lokacioni i nënstacionit \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup> ( për ngrohje qendrore)
- d) Shënimet për kapacitetin dhe sasinë e energjisë që e shfrytëzojnë pajisjet e energjisë që do të kyçen:
- e) Lloji dhe parametrat e sistemit sekondar të konsumatorit / instalimet e brendshme të ngrohjes (për ngrohje qendrore).

**5. Kategori tarifore e zgjedhur \_\_\_\_\_**

**6. Borxhet e vonuara:**

- a) Çdo borxh i vonuar për energji elektrike / ngrohëse në zonën e veprimit të të licencuarit në emër të aplikantit:  
Po/ Jo (Nëse përgjigja është 'Po' ju lutem jepni detajet)  
\_\_\_\_\_
- b) Çdo borxh i vonuar për energji elektrike / ngrohëse për objektin për të cilin është aplikuar kycja:  
Po/Jo (Nëse përgjigja është 'Po' ju lutem jepni detajet)  
\_\_\_\_\_

**7. Me këtë deklaroj se informatat në këtë aplikim janë të vërteta me sa jam në dijeni.**

**8. Dokumentet e bashkangjitura të paraqitura:**

- a) dëshmi e dokumentuar e pronësisë / autorizim për shfrytëzim të pronës.(si psh. Leja për ndërtim,kontratat për shfrytëzim etj.) ;
- b) dokument që dëshmon përfaqësuesin legal;
- c) dëshmi e dokumentuar për autorizim për të dorëzuar aplikacionin e tashëm;
- d) skica e hartës së objektit, që jep dëshmi për pikën e furnizimit;
- e) skica e planit të nënstacionit dhe instalimeve të brendshme të ngrohjes (për ngrohje qendrore);
- f) dëftesa zyrtare e pagesës së taksës në aplikim.



**9. Nënshkrimi i aplikantit / Nënshkruesi i autorizuar:**

Emri:

Data:

Vendi:

**10. Nënshkrimi dhe pronësia e lokacionit ku është sugjeruar në Nenin 1.g) që aplikuesi është pronar i ri:**

Emri:

Nënshkrimi:

Data:

Vendi

**2) Konsumatori komercial**

Kyçja e re / Modifikimi i një marrëveshjeje ekzistuese për kyçje dhe furnizim

(Ju lutem fshijeni qëllimin që nuk është i aplikueshëm)

Për furnizuesin Numri Regjistrues: \_\_\_\_\_

Kërkoj nga ju të kyçni objektin e përshkruar më poshtë në rrjetin e energjisë elektrike/ngrohjes. (Ju lutem fshijeni rastin që nuk është i aplikueshëm)

**1. Aplikanti:**

- a) Emri: \_\_\_\_\_
- b) Përfaqësuesi legal (nëse është e aplikueshme): \_\_\_\_\_
- c) Numri i regjistrimit të biznesit \_\_\_\_\_
- d) Lloji i biznesit \_\_\_\_\_
- e) Adresa: \_\_\_\_\_
- f) Nr. i telefonit: \_\_\_\_\_
- g) E-mail: \_\_\_\_\_
- h) Pronari/ shfrytëzuesi i autorizuar i objektit \_\_\_\_\_  
(Ju lutem fshijeni rastin që nuk është i aplikueshëm)

**2. Përfaqësuesi i aplikantit:**

- a) Emri: \_\_\_\_\_
- b) Përfaqësues Ligjor (nëse është e aplikueshme): \_\_\_\_\_
- c) Adresa: \_\_\_\_\_
- d) Nr. telefonit: \_\_\_\_\_
- e) E-mail: \_\_\_\_\_

**3. Përshkrimi i objektit për të cilin kërkohet kyçja:**

- a) Rruga: \_\_\_\_\_
- b) Nr: \_\_\_\_\_
- c) Qyteti / Fshati: \_\_\_\_\_



- d) Kodi postar: \_\_\_\_\_  
e) Pronari: \_\_\_\_\_  
f) Shfrytëzuesi i autorizuar i objektit: \_\_\_\_\_  
g) Zona e ndërtuar e objektit / ngastra: \_\_\_\_\_

**4. Shënimet teknike:**

Kapaciteti i kërkuar:

- a) \_\_\_\_\_ kVA  
b) Përshkrimi i shfrytëzimit të pronës dhe sipërfaqes së hapësirës që do të furnizohet nga kjo kyçje  
c) Kapaciteti i instaluar \_\_\_\_\_ kW (ngrohje qendrore)  
d) Lloji dhe parametrat e sistemit sekondar të konsumatorit / instalimet e brendshme të ngrohjes ( për ngrohje qendrore).  
e) Shënimet për kapacitetet dhe sasinë e energjisë që e shfrytëzojnë pajisjet e energjisë që do të kyçen:  
f) Përshkrimi i pronës në metër katror

**5. Kategoria tarifore e zgjedhur**

**6. Borxhet e vonuara:**

- a) Çdo borxh i vonuar për energjinë elektrike / ngrohëse në zonën e veprimit të licencuarit në emër të aplikantit:  
Po/ Jo (*Nëse përgjigja është 'Po' ju lutem jepni detajet*)  
\_\_\_\_\_

- b) Çdo borxh i vonuar për energjinë elektrike / ngrohëse për objektin për të cilin aplikohet për kyçje:  
Po/ Jo (*Nëse përgjigja është 'Po' ju lutem jepni detajet*)  
\_\_\_\_\_

**7. Qëllimi i shfrytëzimit të kyçjes**

(Kategoritë)

**8. Ju lutemi përfshini në ofertën për Kyçje formën dhe llojin e pajisjeve matëse**

**9. Me këtë deklaroj se informatat në këtë aplikim janë të vërteta me sa di unë.**

**10. Me këtë kërkoj/ nuk kërkoj konkludim të marrëveshjes plotësuese që siguron kushte specifike në lidhje me mirëmbajtjen e kyçjes, si vijon:**

(Data më të cilën kyçja / zgjerimi i kapacitetit të kyçjes kërcohët. Koha maksimale e lejuar sipas Rregullit KPFE, Nenet 4.3 dhe 8.7 për tu arritur një marrëveshje përfshirë datën e kyçjes është nëntëdhjetë (90) ditë kalendarik – tre (3) muaj.)



**11. Dokumentet e bashkangjitura:**

- a) Dëshmi e dokumentuar e pronësisë / autorizim për shfrytëzim të pronës
- b) Dëshmi e dokumentuar për Nenin e Asociacionit/ Vendimit të Gjykatës/ Kopjes së librit të Aksionarëve
- c) Dëshmi e dokumentuar e përfaqësuesit ligjor
- d) Dëshmi e dokumentuar për autorizim për dorëzim të aplikacionit të tanishëm
- e) Skica e hartës së objektit, që jep indice për pikën e furnizimit
- f) Dëftesa zyrtare e pagesës së taksës në aplikim.
- g) Skica e planit të nënstacionit dhe instalimeve të brendshme të ngrohjes (për ngrohje gendrore)

**12. Nënshkrimi i aplikantit/ Nënshkruesi i autorizuar:**

Emri:

Data:

Vendi:

**SHTOJCA B: OFERTA PËR KYÇJE (PARAQITUR TE FURNIZUESI)**

Operatori i Sistemit:	_____
Numri i regjistrimit të aplikacionit:	_____
Emri i konsumatorit:	_____
Adresa e konsumatorit:	_____
Furnizuesi:	_____

**1. Oferta e tanishme për kyçje është pjesë integrale e marrëveshjes së propozuar për kyçje.**

**2. Zgjidhja e propozuar tekniqe:**

- i. Pika e kyçjes: \_\_\_\_\_
- ii. Përshkrimi i rregullimeve dhe pajisjeve të domosdoshme teknike që duhet të përdoren për kyçje:  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

iii. Data e planifikuar e kyçjes: \_\_\_\_\_

iv. Leja për voltazh, kapacitet maksimal dhe energji:  
\_\_\_\_\_

**3. Kostot e Kyçjes:** \_\_\_\_\_



**4. Përshkrimi i pajisjeve për matje dhe mbrojtje të pajisjeve që duhet të instalohen:**

---

---

---

**5. Çështjet e ndërlidhura me shfrytëzim të rrjetit:**

- i. Tarifa e rekomanduar: \_\_\_\_\_
- ii. Metoda dhe afatet për pagesë të kostove dhe taksave për shfrytëzimin e rrjetit (kreditë e dhëna për kostot që mbulohen nga konsumatori) :

---

**6. Afati për pranim të ofertës për kyçje dhe propozimi për zgjidhje alternative teknike:**

(Afatet e tillë nuk mund të janë më të shkurtra se pesëmbëdhjetë (15) ditë pune pas dorëzimit të ofertës për kyçje)

**SHTOJCA C: KONTRATA PËR FURNIZIM**

Furnizuesi: \_\_\_\_\_

Emri dhe adresa e konsumatorit: \_\_\_\_\_

Pika e furnizimit dhe pika e kufirit: \_\_\_\_\_

Niveli i kapacitetit dhe kapaciteti i garantuar: \_\_\_\_\_

Grupi i konsumatorëve: \_\_\_\_\_

Data e fillimit të furnizimit me energji: \_\_\_\_\_

(Jo më vonë se gjashtë ditë pasi të jetë lidhur kontrata e furnizimit)

Lloji i tarifës: \_\_\_\_\_

Periudha e Faturimit: \_\_\_\_\_

Sistemi i kalkulimit dhe lëshimit të faturave (vlerat e para kalkuluar, telemetër, leximi lokal i njehsorëve të energjisë)

Depozita e Garancës që mbulon shumën e përafërt të pagesës përfurnizim të energjisë për periudhën dy (2) mujore (nëse është e aplikueshme):



**Neni 1**  
**Të Drejtat dhe Obligimet e Konsumatorëve**

Pa paragjykuar ndonjë dispozitë të ndonjë Rregulle të aplikueshme, konsumatorët kanë të drejtat dhe obligimet në vazhdim:

- a) të marrin energji ashtu siç është specifikuar në kontratën përfurnizim dhe marrëveshjen përkryje (nëse është e aplikueshme);
- b) të shfrytëzojnë energjinë e tillë në përputhje me kontratën e furnizimit dhe të mënjanojnë shkaktimin e ndonjë shtrembërim në rrjedhjen e energjisë;
- c) të paguajnë faturat përfurnizim e shfrytëzuar ashtu siç është matur nga pajisjet matëse si dhe shfrytëzimin e rrjetit, në përputhje me tarifat e aplikueshme;
- d) sa më shpejtë të informojë furnizuesin në rast të ndonjë ndërrimi të detajeve përkatëse përfshirë adresat, TVSH, personin e autorizuar etj.
- e) të mos shkel ndonjë prej dispozitave të Nenit 5 të Rregullit përfshirë Shkyçjet dhe Rikyçjet në Sektorin e Energjisë në Kosovë (Shfrytëzim i Paligjshëm).

**Neni 2**  
**Të Drejtat dhe Obligimet e Furnizuesit**

Furnizuesi ka të drejtat dhe obligimet si në vijim:

- a) të furnizoj konsumatorin me energji në sasinë, datën, kohën dhe vazhdimësinë e dakorduar, në përputhje me dispozitat e kontratës përfurnizim ose të ndonjë rregulle ose rregulloreje tjeter të aplikueshme;
- b) të siguroi faturim korrekt të energjisë së shfrytëzuar;
- c) të paguhet përfurnizim e faturuar;
- d) të njoftoi konsumatorin përsyjet e ndërprerjes në furnizim me energji;
- e) të restauroj rrjedhjen e energjisë pas ndërprerjes së arsyeve që kanë shkaktuar ndërprerje në furnizim;
- f) të arrij kualitetin e kërkesës së furnizimit me energji;
- g) të mbledh dhe vëzhgoi të dhënat përkatëse përfshirë Shfrytëzimin e energjisë nga konsumatorët.
- h) të kompensohet përfshirë çfarëdo dëmtimi, humbjeje, të vërtetuara ose harxhimeve të shkaktuara si rezultat i shkeljes së Nenit 5 të Rregullit përfshirë Shkyçjet dhe Rikyçjet e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë të Kosovës (Shfrytëzim i Paligjshëm). Vlera e një kompensimi të tillë duhet të vendoset në përputhje me orarin e dëmtimeve të vlerësuara që duhet të vendosen nga furnizuesi dhe miratohen nga ZRRE-ja brenda periudhës kohore që është në pajtim me Ligjin e Aplikueshëm mbi Obligimet.



**Neni 3**  
**Ruajtja e të Dhënave**

- 3.1 Konsumatorit i bëhet me dije që furnizuesi mund të mbajë detajet personale të tij për qëllim të administrimit të llogarisë së konsumatorit dhe sigurim të shërbimit nga furnizuesi sipas kësaj kontrate dhe kryerjes së punëve tjera të kërkuara nga Ligji dhe përfundimisht furnizuesin të praktikoj të drejtën e tij ligjore.
- 3.2 Ruajtja mund të vazhdoj pas mbylljes së llogarisë së konsumatorit. Në veçanti, konsumatorit i bëhet me dije që Neni 25 përfundimisht e përgjithshme të Furnizimit me Energji lejon furnizuesin t'i dërgoj informata institucioneve të autorizuara.

**Neni 4**  
**Depozita e Garantimit (nëse është e aplikueshme)**

- 4.1 Depozitimi i garantimit do të paguhet me para në dorë ose me depozitim në bankë.
- 4.2 Nuk do të këtë kamatë përfundimisht e garantimit gjatë zbatimit të kontratës së furnizimit.
- 4.3 Depozitimi i garantimit do ti kthehet konsumatorit vetëm pasi të ndërpritet kontrata përfundimisht dhe pasi të jenë rregulluar borxhet e mbetur, nëse ka ndonjë, brenda periudhës një mujore që nga data e ndërprerjes.
- 4.4 Në rast se nuk kthehet depozitimi i garantimit gjatë periudhës së lartpërmendur, duhet ti bartet vlera e kamatës prej normës (%) përfundimisht përvite e paguar nga konsumatori.

**Neni 5**  
**Obligimi i Vazhdimësisë**

Furnizuesi është përgjegjës përfundimisht për të siguruar rrjedhje të vazhdueshme me energji përmes pikës së kyçjes pa prejudikuar ndonjë kusht të kontratës përfundimisht kufizime kohore.

**Neni 6**  
**Ndërprerjet në Furnizim**

- 6.1 Në rast të ndonjë ndërprerje në furnizim, furnizuesi është i obliguar të kthej rrjedhjen e energjisë sa më shpejtë që është e mundur dhe të ndërmarr të gjitha masat e duhura përfundimisht arsyesh, duke përfshirë themelimin e shërbimeve të përhershme të emergencës.
- 6.2 Me kërkesë të konsumatorit furnizuesi do ti ofroj atij çdo informatë që ka në disponicion në lidhje me kohëzgjatjen e ndërprerjeve aksidentale dhe kohëzgjatjen e parashikuar që është e nevojshme përfundimisht e rrjedhjes së energjisë. Obligimi përfundimisht e informuar konsumatorët nuk është i nevojshëm, nëse një informim i tillë nuk ka arsyetim praktik përfundimisht përfundimisht apo nëse ri-vendosja e furnizimit ka filluar.



**Neni 7**  
**Ndërprerjet Aksidentale**

- 7.1 Në rast të ndërprerjeve aksidentale të furnizimit me energji konsumatorët duhet të njoftojnë furnizuesin me përpikëri.
- 7.2 Furnizuesi duhet të ofroi shërbime emergjente me palët kontraktuese brenda periudhës duke filluar nga njoftimi i ndërprerjes aksidentale siç është vendosur në Performancën Standarde të Kualitetit nxjerrë nga ZRRE.

**Neni 8**  
**Ndërprerjet e Planifikuara**

Furnizuesi do të informoi konsumatorët për ndonjë ndërprerje në kohëzgjatjen e vlerësuar duke tejkaluar periudhën minimale të përcaktuar për riparimin e planifikuar në kontratën për furnizim, së paku njëzetekatër (24) orë më herët, pas pranimit nga operatori i sistemit, përveç nëse është ndonjë rast emergjentë. Informatat duhet të ofrohen me çfarëdo mjete që konsiderohen të qëlluara me synim që të sigurohet publicitet maksimal.

**Neni 9**  
**Kufizimet e Furnizimit për shkak të Rrjetit**

- 9.1 Në rast të kufizimit të furnizimit për shkak të kushteve të rrjetit, furnizuesi ka të drejtë që t'ju ofroi konsumatorëve sasi të kufizuar të energjisë. Në raste të tillë furnizuesi do të përpinqet sa më shumë që është e mundur që të informoi konsumatorët së paku njëzetekatër (24) orë më herët.
- 9.2 Aplikimi i paragrafit të mëparshëm mund të konsiderohet vetëm për rastet të pëershkuara në Nenin 33 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

**Neni 10**  
**Kërkesat për Kualitetit në lidhje me Furnizimit me Energji**

Furnizuesi do të furnizoi me energji elektrike në përputhje me kërkesat e kualitetit të paraqitura në kodet teknike dhe standartet e zbatueshme të kualitetit të shërbimeve të përcaktuara në licence.

**Neni 11**  
**Faturimi dhe Pagesat**

Në përputhje me Nenet 22 dhe 24 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.



**Neni 12**

**Klauzolat e Gjobave**

Siç është referuar në Nenin 25, 26 dhe 32.6 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energi

**Neni 13**

**Zgjidhja e Ankesave**

- 13.1 Konsumatori duhet të raportoj menjëherë tek furnizuesi çdo ankesë në lidhje me shërbimet e ofruara ose çështjet e faturimit.
- 13.2 Ankesat ju nënshtrohen Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Neni 14**

**Ndërprerja e Kontratave të Furnizimit**

- 14.1 Konsumatorët mund të ndërprenë kontratën për furnizim pa arsyetuar pasi që të kenë përbushur të gjitha obligimet e tyre që rrjedhin nga kontratat e tillë dhe të kenë njoftuar me shkrim furnizuesin për këtë rezultat së paku shtatë (7) ditë kalendarike më herët.
- 14.2 Furnizuesit që kryejnë shërbime mund të ndërprenë kontratën për furnizim vetëm duke pasur arsyë dhe në përputhje me proceduat e ofruara në Rregullen për Shkyçje dhe Rikycje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.
- 14.3 Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës për ngjarjet jashtë kontrollit të arsyeshëm, duke përfshirë por jo edhe kufizuar në vis major (katastrofat natyrore, vërshimet, zjarrin, tërmelin etj) apo ngjashëm, aktet e autoriteteve, sulmeve, protestave, konflikteve apo ngjarjeve të ngjashme..